



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A UJESJELLES-KANALIZIME DIBER

Nr. _____ Prot.
13.03.2019

Peshkopi, më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: Shoqerine “KEVENJO” Shpk
Adresa: Diber, Peshkopi, Lagjja e re.

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për propozim” - Shërbime**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-93069-11-06-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit” – Marrëveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj, Fondi i Marrëveshjes Kuader për 12 muaj- 5,969,212 (pese milion e nentëqind e gjashtëdhjetë e nente mijë e dyqind e dymbëdhjetë) leke pa TVSH**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike [Dt. 12.11.2018] [Nr. 45]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“SAFE”** **Shpk**
K41424040P

Vlera: **5 831 852,9** (pese milion e teteqind e tridhjetë e një mijë e teteqind e pesëdhjetë e dy,9) leke pa TVSH.

2. **“EUROGJICI-SECURITY”** **Shpk**
K31929010K

Vlera: **5 831 852,9** (pese milion e teteqind e tridhjetë e një mijë e teteqind e pesëdhjetë e dy,9) leke pa TVSH.

3. **“GRAND SECURITY”** **Shpk**
K51705027S

Vlera: **5 831 852,9** (pese milion e teteqind e tridhjetë e një mijë e teteqind e pesëdhjetë e dy,9) leke pa TVSH.

4. **“INTERNATIONAL SECURITY ALBANIA”** **Shpk**
L02004016V

Vlera: **5 831 852,9** (pese milion e teteqind e tridhjetë e një mijë e teteqind e pesëdhjetë e dy,9) leke pa TVSH.

5. **“KEVENJO”** **Shpk**
K36308746I

Vlera: **5 831 852,9** (pese milion e teteqind e tridhjetë e një mijë e teteqind e pesëdhjetë e dy,9)

leke pa TVSH.

6. "NAZERI
K31422029Q

–

2000"

Shpk

Vlera: **5 831 852,9** (pese milion e teteqind e tridhjetë e një mijë e teteqind e pesedhjetë e dy,9)
leke pa TVSH.

7. "SNAJPER
K77217701L

SECURITY"

Shpk

Vlera: **5 831 852,9** (pese milion e teteqind e tridhjetë e një mijë e teteqind e pesedhjetë e dy,9)
leke pa TVSH.

8. "TREZHNJEVA"
K19303605O

Shpk

Vlera: **5 831 852,9** (pese milion e teteqind e tridhjetë e një mijë e teteqind e pesedhjetë e dy,9)
leke pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. "GRAND SECURITY" Shpk

K51705027S

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta operatorit ekonomik "GRAND SECURITY" Shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme për këtë procedurë. Konkretisht:

Operatori ekonomik "GRAND SECURITY" Shpk, ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi dokumentin e leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Diber (në mënyrë elektronike) me Nr. T00724307, datë 12.12.2018, mbi "Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për tatimpaguesin – E-SIG 02/a" për subjektin "Grand Security" Shpk, ku konstatohet në këtë dokument si dhe në listpagesat shoqëruar bashkelidhur që për muajin shtator 2017 numrin e kontributeve (punonjës të siguruar) është 9 (nente) si dhe për muajin dhjetor 2017 numrin e kontributeve (punonjës të siguruar) është 10 (dhjetë). Dokumenti i cili nuk është në përputhje dhe sipas kërkesës së AK të parashikuara në dokumentet e tenderit në kriteret e vecanta në lidhje me kapacitetin teknik pika 3 ku kërkohej: 3. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Shtator 2017 - Shtator 2018 për 10 punonjës për çdo muaj, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj (10 punonjës shërbimi roje) si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Gjithashtu konstatohet që subjekti "GRAND SECURITY" Shpk ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi 5 (pese) certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave, ku nderkohe në dokumentet e tenderit të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik të kriteret e vecanta të kualifikimit në lidhje me kapacitetin ligjor të operatoreve ekonomik pika 3 kërkohej: 3. Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 10 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Diber. Për sa me sipër dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik "GRAND SECURITY" Shpk, është i paplote pasi nuk ka përmblusur Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në lidhje me kapacitetin ligjor të operatoreve ekonomik pika 3 dhe në lidhje me kapacitetin teknik pika 3.

2. “INTERNATIONAL SECURITY ALBANIA” Shpk

L02004016V

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “INTERNATIONAL SECURITY ALBANIA” Shpk, ka paraqitur ne kete procedure prokurimi dokumentin e leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Diber me Nr. 213/2 Prot., date 11.07.2018, mbi “AKT MIRATIMI per Qendren e Kontrollit te SHPSF-se” per subjektin “INTERNATIONAL SECURITY ALBANIA” Shpk, ku konstatohet ne kete dokument se adresa e Qendres se Kontrollit eshte: Zona e Pare, Bashkia Bulqize. Dokument i cili nuk eshte ne perputhje dhe sipas kerkeses se AK te parashikuara ne dokumentet e tenderit ne kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin teknik pika 2 ku kerkohet: *2. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Qarkut Diber me seli ne qytetin e Peshkopise si dhe Dokumenti i Performaces mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit te operatorit ekonomik sipas udhezimit nr. 130, date 05.03.2018 i Ministrit te Puneve te Brendshme ”Per funksionimin e sherbimit privat te sigurise fizike”...*

Per sa me siper dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “INTERNATIONAL SECURITY ALBANIA” Shpk, eshte i paplote pasi nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne lidhje me kapacitetin teknik pika 2.

3. “NAZERI – 2000” Shpk

K31422029Q

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “NAZERI - 2000” Shpk, ka paraqitur ne kete procedure prokurimi dokumentin e leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Diber me Nr. 213/1 Prot, date 11.07.2018, mbi “AKT MIRATIMI per Qendren e Kontrollit te SHPSF-se” per subjektin “NAZERI - 2000” Shpk, ku konstatohet ne kete dokument se adresa e Qendres se Kontrollit eshte: Rruga nacionale “Peshkopi-Kukes”, Autoservis Hysa, Njesia Administrative Tomin, Bashkia Peshkopi. Dokument i cili nuk eshte ne perputhje dhe sipas kerkeses se AK te parashikuara ne dokumentet e tenderit ne kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin teknik pika 2 ku kerkohet: *2. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Qarkut Diber me seli ne qytetin e Peshkopise si dhe Dokumenti i Performaces mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit te operatorit ekonomik sipas udhezimit nr. 130, date 05.03.2018 i Ministrit te Puneve te Brendshme ”Per funksionimin e sherbimit privat te sigurise fizike”...*

Gjithashtu konstatohet qe subjekti “NAZERI - 2000” Shpk ka paraqitur ne kete procedure prokurimi 4 certifikata (3 certifikata te rregullta dhe njera e korrigjuar) për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Diber dhe certifikatat e tjera te paraqitura për punonjës shërbimi jane leshuar nga Drejtoria e Policise Tirane, ku nderkohe ne dokumentet e tenderit te publikuara ne sistemin e prokurimit elektronik te kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin ligjore te operatoreve ekonomik pika 3 kerkohet: *3. Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 10 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Diber.*

Per sa me siper dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “NAZERI - 2000” Shpk, eshte i paplote pasi nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne lidhje me kapacitetin ligjor te operatoreve ekonomik pika 3 dhe ne lidhje me kapacitetin teknik pika 2.

4. “SNAJPER SECURITY” Shpk

K77217701L

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “SNAJPER SECURITY” Shpk, ka paraqitur ne kete procedure prokurimi dokumentin e leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Diber me Nr. 241 Prot.,, date 01.08.2018, mbi “AKT MIRATIMI per Qendren e Kontrollit te SHPSF-se” per subjektin “SNAJPER SECURITY” Shpk, ku konstatohet ne kete dokument se adresa e Qendres se Kontrollit eshte: Lagja “Pjeter Budi”, Ish Shtepia e Ushtarakeve, Bashkia Burrel. Dokument i cili nuk eshte ne perputhje dhe sipas kerkeses se AK te parashikuara ne dokumentet e tenderit ne kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin teknik pika 2 ku kerkohet: *2. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Qarkut Diber me seli ne qytetin e Peshkopise si dhe Dokumenti i Performaces mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik sipas udhezimit nr. 130, date 05.03.2018 i Ministrit te Puneve te Brendshme ”Per funksionimin e sherbimit privat te sigurise fizike”...*

Gjithashtu vertetim i debise nr. 356 prot., date 12.10.2018 i paraqitur ne kete procedure prokurimi ka perfshire muajin shtator 2018 ka te perfshire faturen koherente te muajit shtator 2018, nderkohe referuar periudhes se zhvillimit te tenderit duhej te paraqitej vertetimi per faturen koherente te muajit tetor 2018.

Per sa me siper dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “SNAJPER SECURITY” Shpk, eshte i paplote pasi nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne lidhje me kapacitetin teknik pika 2.

Duke qene se operatoret ekonomik: “SAFE” Shpk, “EUROGJICI-SECURITY” Shpk, “KEVENJO” Shpk dhe TREZHNJEVA” Shpk, pas rivleresimit te ofertave ne zbatim te vendimit te KPP-se Nr. 82/2019 date 13.02.2019, jane OE te kualifikuar dhe te renditur te paret ne klasifikim me vlere te njejte prej: 5 831 852,9 (pese milion e teteqind e tridhete e nje mije e teteqind e pesedhete e dy,9) leke pa TVSH, u njoftuan dhe me date 08.03.2019 ne Sh.A Ujesjelles-Kanalizime Diber u hodh shorti ne prezence te perfaqesuesve te operatoreve ekonomik pjesemarres per shpalljen e fituesit. Nga shorti i hedhur u shpall fitues operatori ekonomik: “KEVENJO” Shpk, ku per kete qellim u mbajt dhe procesverbali i dates 08.03.2019 i cili u firmos pa kontestime nga perfaqesuesit e operatoreve ekonomik pjesemarres.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

**1. “KEVENJO”
K36308746I**

Shpk

Vlera: 5 831 852,9 (pese milion e teteqind e tridhete e nje mije e teteqind e pesedhete e dy,9) leke pa TVSH.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Sh.a Ujesjelles Kanalizime Diber, adresa: Diber Peshkopi, Lagjja "Treg", Rruga "Ismail Feta", Tel/Fax 00355 0218 2 2761, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 22.02.2019

Ankesa: Ka patur, kane marr pergjigje me 30.12.2018 si dhe me vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik me Nr. 82/2019 date 13.02.2019

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Bedri KAMBERI